

20071331756

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E LIGJIT PËR REVIZIONIN SHETËTOR

Neni 1

Në Ligjin për revizionin shtetëror (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, numër 65/97, 70/2001, 31/2003, 19/2004, 73/2004 dhe 70/2006), pas nenit 27-b shtohet kapitulli i ri III-b dhe shtatë nene të reja 27-v, 27-g, 27-d, 27-gj, 27-e, 27-zh, dhe 27-z, si vijojnë:

“III-b. TRUPI REVIZOR PËR FONDET PARA-HYRËSE TË UNIONIN EVROPIAN NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Neni 27v

Në Entin shtetëror për revizion, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Trup të revizionit në sistemin e administrimit me fondet para-hyrëse të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë, si trup revizor funksional autonom (në tekstin e mëtejme: trupi revizor).

Trupi revizor, bën revizionin e instrumentit për ndihmë para hyrjes-Fondet IPA (në tekstin e mëtejme: Fondet IPA).

Trupi revizor është autonom nga format organizative të Entit shtetëror për revizion.

Struktura e organikës së Trupit të revizionit përcaktohet me akt, të miratuar nga udhëheqësi i Trupit të revizionit.

Bashkëpunimi i Trupit të revizorit me Entin shtetëror të revizionit, do të realizohet në pajtim me Memorandumin për mirëkuptim dhe bashkëpunim midis Entin shtetëror për revizion dhe Trupit të revizorit.

Trupi revizor, bën verifikimin e: efikasitetit të funksionimit të sistemit për administrimin dhe kontrollin e fondeve para- hyrëse të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë dhe autenticitetin e transaksioneve të kontabilitetit të dorëzuara në Komisionin Evropian, sipas metodologjisë së punës që përgatitet në pajtim me Standardet ndërkombëtare për revizionin e institucioneve supreme (INTOSAI).

Neni 27-g

Trupi revizor çdo viti miraton plan vjetor të revizionit për punë, që është i pavarur dhe autonom nga Plani vjetor i Entit shtetëror për revizion.

Trupi revizor planin vjetor për punë nga paragrafi 1 të këtij neni ia dorëzon Koordinatorit nacional për Autorizim dhe Komisionit Evropian, deri në fund të vitit në vijim për vitin e ardhshëm.

Trupi revizor, më së voni deri 31 dhjetor çdo vit përgatit raport vjetor të revizionit në pajtim me Marrëveshjen kornizë të lidhur midis Komisionit dhe Republikës së Maqedonisë për implementimin e IPA Normativës. Raporti vjetor i revizionit e përfshin periudhën për 12 muajt e kaluar, duke përfunduar me 30 shtator për vitin që është lëndë e revizionit.

Trupi revizor përgatit mendim vjetor për periudhën nga paragrafi 3 të këtij neni dhe dorëzon njëkohësisht me Raportin vjetor të revizionit dhe paraqet verifikim, me qëllim që të konstatojë se sistemi i administrimit dhe kontrollit a funksionon në mënyrë efikase dhe në pajtim me IPA Normativën e Komisionit Evropian dhe marrëveshjet tjera ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë.

Trupi revizor, Raportin vjetor dhe Mendimin vjetor ia dorëzon Komisionit Evropian, koordinatorit kompetent për akreditim dhe koordinatorit për autorizim.

Trupi revizor përgatit mendim për raportin përfundimtar, për shpenzimet për mbarimin e plotë ose të pjesshëm të programeve të financuara nga fondet IPA. Raporti përfundimtar për shpenzimet përgatitet dhe i dorëzohet Komisionit Evropian nga ana e koordinatorit nacional për autorizim.

Sipas nevojës mendimi për raportin përfundimtar për shpenzimet mund të shoqërohet me raportin e revizorit të përpunuar nga ana e Trupit revizor, për periudhën që nuk ka qenë i paraparë para mbarimit të plotë ose të pjesshëm të programit.

Trupi revizor, mendimin për raportin përfundimtar e përgatit në pajtim me Marrëveshjen kornizë dhe ia dorëzon Komisionit Evropian dhe koordinatorit kompetent për akreditim njëkohësisht ose në periudhë prej tre muajve pas paraqitjes së Raportit përfundimtar nga koordinatori nacional për autorizim në Komisionin Evropian.

Plani vjetor, Raporti vjetor i revizorit dhe Mendimi vjetor përgatiten dhe dorëzohen në gjuhën maqedonase dhe angleze.

Raporti vjetor dhe Mendimi vjetor i trupit revizor, nuk janë pjesë përbërëse të Raportit vjetor të Entit shtetëror për revizion.

Neni 27-d

Punët e revizionit të Trupit revizor mund t'i bëjnë revizorët e autorizuar shtetërorë dhe revizorët shtetërorë nga Enti shtetëror i revizionit të Republikës së Maqedonisë të sistemuar për kryerjen e punëve në Trupin revizor në pajtim me aktin nga neni 27 paragrafi 4 të këtij ligji.

Revizorët e autorizuar shtetërorë ose revizorët shtetërorë që bëjnë revizionin e sistemimit dhe funksionalitetit të sistemeve strukturore dhe kontrolluese për administrim me fondet IPA realizojnë të drejtën e rrogës dhe mund të fitojnë plotësimin e rrogës me pagesën e shpërblimeve mujore në para, për shkak të kushteve të posaçme dhe përgjegjësisë që del nga vendi i punës në pajtim me nenin 27-b të këtij ligji.

Lartësinë e shpërblimit në para dhe të plotësimit të rrogës nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton udhëheqësi i trupit revizor.

Neni 27-gj

Me Trupin revizor për kryerjen e revizionit të Fondeve IPA udhëheq udhëheqësi të cilin e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim dhe në pajtim me revizorin kryesor shtetëror.

Udhëheqësi i Trupit revizor për kryerjen e revizionit të Fondeve IPA është përgjegjës për implementimin e pjesës së buxhetit - ndarjes së dedikuar për Entin shtetëror për revizion që ka të bëjë me zërin për Trupin revizor për kryerjen e revizionit të IPA Fondeve.

Udhëheqësi i trupit revizor për kryerjen e revizionit të Fondeve IPA është nënshkruar i vetëm i Planit vjetor të revizionit, Raportit vjetor të revizionit, Mendimit vjetor dhe Mendimit për raportin përfundimtar për shpenzimet për mbarimin e plotë ose të pjesshëm të programeve, propozimit të pjesës së buxhetit që ka të bëjë me Trupin revizor dhe aktet tjera lidhur me funksionimin e Trupit revizor për kryerjen e revizionit të Fondeve IPA.

Neni 27-e

Trupi revizor për realizim e aktiviteteve të veta, bashkëpunon me institucionet kompetente të revizorit dhe trupa nga vendet anëtare të Unionit Evropian, kandidate dhe vendet potenciale kandidate për anëtarësim në Unionin Evropian.

Neni 27-zh

Mjetet për financim të Trupit revizor, sigurohen nga Buxheti i Entit shtetëror për revizion me programin "Trupi revizor për fondet para-hyrëse të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë".

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni përgatitet nga ana e Trupit revizor dhe nuk i nënshtrohet lejimit nga ana e Entit shtetëror për revizion.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në mënyrë të ndarë voton për programin nga paragrafi 1 të këtij neni të ndarjes së Entit shtetëror për revizion që dedikohet për Trupin revizor në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 27-z

Në funksion të realizimit të aktiviteteve të veta, Trupi revizor ka qasje të plotë në të gjitha informatat dhe dokumentet që janë të lidhura me projekte ose programe që janë të financuara plotësisht ose pjesërisht me mjete para-hyrëse të Fondeve IPA.

Neni 2

Titulli para nenit 29 “IV. DISPOZITAT NDËSHKUESE” ndryshon si vijon: “V. SANKSIONET PËR KUNDËRVAJTJE”

Neni 3

Në nenin 28, paragrafi 1, në fjalinë hyrëse fjalët: “Me dënim me para prej 10000 deri 300 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje” zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në shumë prej 1 000 euro deri 6 000 euro me kundërvlerë në denarë do të shqiptohet për kundërvajtje”:

Paragrafi 2 ndryshon si vijon:

“Gjobë në shumë prej 500 deri 2 500 euro me kundërvlerë në denarë, do t’i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik subjektit të i cili bëhet revizioni. “

Neni 4

Në nenin 29, paragrafi 1, në fjalinë hyrëse fjalët:

“Me dënim në para prej 10000 deri 50000 denarë”, zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në shumë prej 500 euro deri 2 500 euro me kundërverë në denarë:

Neni 5

Dispozitat e kapitullit III-b të këtij ligji do të zbatohen deri në hyrjen e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.